



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Sr. Prot. Sr. Prot. Prof. No.	25
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	30.01.2018
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/25/2018

Datë: 17/01/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e tetë të përbërjes së parë, të mbajtur më 17 janar 2018, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohen procesverbalet e takimit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, si në vijim:
  - 1.1 procesverbali i takimit të mbajtur me datë 19 tetor 2017;
  - 1.2 procesverbali i takimit të mbajtur me datë 01 dhjetor 2017;
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	26
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	30.01.2018
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/26/2018  
Datë: 17/01/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në takimin e tetë të përbërjes së parë, të mbajtur më 17 janar 2018, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Plani i Punës i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2018.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.



Aleksandër Lumezi

*A. Lumezi*  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:  
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë





REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Shënimi, Org. rg. Jedin. rg. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	27
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	30.01.2018
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/27/2018  
Datë: 17/01/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.9, nenit 11 paragrafi 4 dhe nenit 25 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, si dhe nenit 15 paragrafi 4 i Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e tetë të përbërjes së parë, të mbajtur më 17 janar 2018, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Mentorët e angazhuar në Trajnimin Fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar do të kompensohen në shumë prej 100 (njëqind) euro bruto në muaj.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e mentorëve janë të përcaktuara me aktet normative të Akademisë së Drejtësisë dhe me kontratë.
3. Vendimi vlen deri me datë 31 dhjetor 2018.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Kopja e vendimit i dërgohet:

Mentorëve të Akademisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	28
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	03	Data Datum Date	30.01.2018
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/28/2018

Datë: 17/01/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, 11 paragrafi 4, dhe nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, bazuar në nenin 14 të Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, dhe nenit 2 të Rregullores Nr.08/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK, Nr.342/2017, të datës 07 dhjetor 2017, në takimin e tetë të përbërjes së parë, të mbajtur më 17 janar 2018 merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Mentorët që do të angazhohen për të mentoruar gjyqtarët e sapoemëruar, në trajnimin fillestar, si në vijim:

1.1 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, janë si në vijim:

- 1.1.1 Afërdita Bytyqi, mentore për lëmin penale;
- 1.1.2 Arben Hoti, mentor për lëmin penale;
- 1.1.3 Shadije Gërguri, mentore për lëmin penale;
- 1.1.4 Shpresa Hasaj-Hyseni, mentore për lëmin penale;
- 1.1.5 Beqir Kalludra, mentor për lëmin penale;
- 1.1.6 Hamdi Ibrahim, mentor për lëmin penale;
- 1.1.7 Valbona Musliu, mentore për lëmin penale;
- 1.1.8 Suzana Çerkini, mentore për lëmin penale;
- 1.1.9 Vesel Ismajli, mentor për lëmin penale;
- 1.1.10 Shashivar Hoti, mentor për lëmin penale;
- 1.1.11 Naser Foniqi, mentor për lëmin penale;
- 1.1.12 Vehbi Kashtanjeva, mentor për lëmin penale;
- 1.1.13 Elife Uka, mentore për lëmin penale;
- 1.1.14 Hanefi Jashari, mentor për lëmin penale;

1.2 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj janë si në vijim:

- 1.2.1 Bashkim Hyseni, mentor për lëmin penale;
- 1.2.2 Enes Mehmeti, mentor për lëmin civile;
- 1.2.3 Zajrete Muhaxhiri, mentore për lëmin penale;



1.3 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore në Gjilan janë si në vijim:

- 1.3.1 Agim Ademi, mentor për lëmin penale;
- 1.3.2 Ramiz Azizi, mentor për lëmin penale;
- 1.3.3 Luljetë Shabani, mentore për lëmin penale;
- 1.3.4 Milorad Mitković, mentor për lëmin civile;
- 1.3.5 Mirvete Alidema, mentore për lëmin civile;

1.4 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore në Pejë janë si në vijim:

- 1.4.1 Lumturije Muhaxhiri, mentore për lëmin penale;
- 1.4.2 Sami Sharraxhiu, mentor për lëmin penale;
- 1.4.3 Sejdi Blakaj, mentor për lëmin penale;

1.5 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore në Prizren janë si në vijim:

- 1.5.1 Fatmir Krasniqi, mentor për lëmin penale;
- 1.5.2 Agron Hoxhaj, mentor për lëmin civile;

1.6 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë janë si në vijim:

- 1.6.1 Burim Ademi, mentor për lëmin penale;
- 1.6.2 Avni Mehmeti, mentor për lëmin penale;
- 1.6.3 Ali Kutllovci, mentor për lëmin penale;
- 1.6.4 Sabit Rama, mentor për lëmin penale;

2. Mandati i mentorëve të emëruar përfundon, me përfundimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar që janë në programin e trajnimit fillestar, nëse gjatë kohës së trajnimit fillestar ndryshon funksionin e tyre si gjyqtar, nëse kalon nga niveli themelor në nivel tjera të gjykatës, apo kalon nga Departamenti i Përgjithshëm në departamente tjera, siç përcaktohet me rregullore.
3. Mentorët angazhohen për të zbatuar programin e trajnimit praktik në fushën penale për periudhën e mbetur të 6 mujorit të parë të trajnimit dhe 6 muaj tjerë në fushën civile.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të bërë sipas vendimit KGJK, Nr.342/2017, të datës 07 dhjetor 2017, ka shqyrtuar dhe miratuar listën e propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me disa ndryshime të propozuara nga përfaqësuesit e KGJK-së, në Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë.

Këshilli Drejtues i Kosovës me datë 12.09.2017, ka nxjerrë Vendimin Nr.01/220/2017, për miratimin e mentorëve të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me Vendimin Nr.KGJK, nr.250/2017 të datës 09.08.2017, duke refuzuar disa nga propozimet për shkak se ka vlerësuar se janë në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e




Akademisë së Drejtësisë “të jenë gjyqtarë dhe prokurorë me mandat të përhershëm në departamentin e përgjithshëm të nivelit themelor”.

Për shkak të numri të madh të gjyqtarëve në trajnimin fillestar dhe numrit të vogël të gjyqtarëve në Departamentin e Përgjithshëm, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, me Vendimin Nr. 01/284/2017 të datës 01.12.2017, ka miratuar Rregulloren Nr.08/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, sipas të cilës jepet mundësia që mentor të caktohen jo vetëm gjyqtarët nga Departamenti i Përgjithshëm të gjykatës themelore, por edhe ata që punojnë në departamente tjera kur ka mungesë të gjyqtarëve në Departament të Përgjithshëm.

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë nuk ka miratuar në tërësi propozimet e Këshillit Gjyqësor të propozuara me vendimin KGJK, Nr.342/2017, të datës 07 dhjetor 2017, pasi që në Gjykatën Themelore në Prizren janë propozuar më shumë mentor se sa ka gjyqtarë pjesëmarrës në trajnimin fillestar. Lidhur me këtë Këshilli Drejtues ka miratuar dy (2) mentor nga katër (4) sa ishin propozuar, sipas propozimit nga përfaqësuesit e KGJK-së, në Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë.

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë vlerëson se angazhimi i këtyre mentorëve do të lehtësoj punën e mentorëve me gjyqtarët në trajnim si dhe do të rris mundësinë e përfimit profesional të gjyqtarëve në trajnimin praktik, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Akademisë së Drejtësisë  
Mentorëve të emëruar



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/29/2018

Datë: 17/01/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.9, nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, dhe nenit 13 paragrafi 13.2 i Rregullores Nr.01/2014 për Kërkime dhe Publikime në Institutin Gjyqësor të Kosovës të datës 07.04.2014, në mbledhjen e tetë të përbërjes së parë, të mbajtur më 17 janar 2018, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Anëtarët e Këshillit të Redaksisë kompensohen në shumën prej 100 (njëqind) euro për redaktimin e një artikulli i cili është i dedikuar për publikim në revistën "Justicia".
2. Numri i artikujve për redaktim, përgjegjësitë dhe të drejtat e anëtarëve të redaksisë përcaktohen me aktet normative të Akademisë dhe kontratë të veçantë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

*A. Lumezi*

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Akademisë së Drejtësisë





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	30
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	30.01.2018
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/30/2018  
Datë: 17/01/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, dhe nenit 5 të Rregullores Nr.03/2017 për Trajnimin Fillestar, në mbledhjen e tetë të përbërjes së parë, të mbajtur më 17 janar 2018, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Programi i Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapoemëruar, të dekretuar me datë 22 janar 2018.
2. Ky program do të zbatohet për gjeneratën e shtatë të prokurorëve në trajnimin fillestar, i cili do të filloj në vitin 2018.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit Ekzekutiv të AD-së  
Udhëheqësit të PTF-së  
Këshillit Prokurorial të Kosovës  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë